

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Valdete Daka dhe Agim Maliqi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale të dënuarit K.A., nga Prizreni, për shkak të veprës penale të grabitjes nga neni 329 par.1 të KPK-së dhe të pandehurit R.U. nga Prizreni, për shkak të veprës penale pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.1 të KPK-së, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, të ushtruar nga mbrojtësi i të dënuarit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren – DKR P.nr.1/2017 datë 15.5.2017, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.352/2017 datë 7.9.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 3.4.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit K.A., ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren – DKR P.nr.1/2017 datë 15.5.2017, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.352/2017 datë 7.9.2017.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren – DKR P.nr.1/2017 e datës 15.5.2017, i dënuari K.A., është shpallë fajtor për shkak të veprës penale të grabitjes nga neni 329 par.1 të KPK-së dhe për këtë vepër është gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 500 € si dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) viteve, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 10.11.2016 deri më datë 25.4.2017. I dënuari është obliguar që dënimin me gjobë ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e nëse nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, gjykata mund t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, ashtu që për një ditë burg do t'i llogaritet 20 € nga gjoba e shqiptuar. I dënuari po ashtu është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 200 €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Me të njëjtin aktgjykim i pandehuri R.U., konform nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPPK-së, është liruar nga akuza për veprën

penale pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.1 të KPK.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.352/2017 e datës 7.9.2017, ka refuzuar ankesat e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren dhe të mbrojtësit të dënuarit K.A., kurse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit K.A., av. R.H., nga Prizreni, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.8. dhe par.2 nënpar.2.2, në lidhje me nenet 120 par.1 dhe 2; 262 par.1 dhe 370 par.7 të KPPK-së, me propozim që aktgjykimet e kontestuara të ndryshohen dhe të merret aktgjykim lirues ose të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim. Po ashtu, në kuptim të nenit 435 par.4 të KPPK-së, ka propozuar që të shtyhet ekzekutimi i dënimit deri në përfundim të procedurës sipas kërkesës.

Prokurori i Shtetit me parashtresën KMLP.II.nr.207/2017 e datës 10.11.2017, ka propozuar që të refuzohet si e pabazë kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e ushtruar nga mbrojtësi i të dënuarit.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës në pajtim me dispozitën e nenit 435 par.1 dhe 436 të KPPK-së, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa, ka gjetur:

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar.

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sepse të njëjtit mbështeten vetëm në një provë dhe atë në dëshminë e të dëmtuarës si dëshmitare, L.H., e cila është provë e papranueshme sepse është siguruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 120 par.1 dhe 2 dhe nenin 262 par.1 të KPPK-së. Kjo nga fakti se e dëmtuara gjatë të identifikimit-të njohjes së të pandehurit K.A. është kryer pa prezencën e mbrojtësit të të pandehurit dhe se e njëjta fillimisht në bazë të përshkrimit të saj, në stacionin policor, ka identifikuar si sulmues ndaj saj personin P.M., ndërkaq po e njëjta e dëmtuar më datë 10.12.2016 në Stacionin Policor në Prizren, ka identifikuar tani të dënuarin K.A., gjë që e bën që dëshmia e kësaj dëshmitareje – të dëmtuare të jetë jokredibile dhe të pabesueshme. Andaj, aktgjykimi nuk ka mundur të bazohet vetëm në deklaratën e saj, sepse nuk ka prova të tjera të cilat vërtetojnë se i dënuari ka kryer veprën penale për të cilën është shpallë fajtor.

Gjykata Supreme, duke vlerësuar pretendimet nga kërkesa si dhe pasi shqyrtoi shkresat e çështjes konstatoi se, qëndron fakti se identifikimi i kryer nga ana e të dëmtuarës L.H. është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore mbi identifikimin, konkretisht nenit 120 të KPPK-së, pasi që me rastin e identifikimit të dëmtuarës i është prezantuar vetëm i dënuari. Mirëpo, gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj ka

dhënë arsye të mjaftuara ligjore të cilat i ka pranuar edhe gjykata e shkallës së dytë, sepse ka gjetur se i dënuari është fajtor për veprën për të cilën është shpallur fajtor. Duke u bazuar në shkresat e çështjes, kjo Gjykatë gjen se i dënuari K.A. ia ka shitur telefonin “Samsung Galaxy J5A” për 100 franga tani të liruarit R.U., telefon ky i cili ishte identifikuar nga L.H., si telefoni i cili ishte në çantën e cila i është grabitur natën kritike më datë 27.1.2016 nga një person i cili më vonë është identifikuar si i dënuari K.A.. Po ashtu, nga shkresat e çështjes është vërtetuar se R.U. e kishte blerë telefonin “Samsung” ngjyrë të bardhë, nga i dënuari K.A., të cilin e njihte nga lagjja për një shumë prej 100 franga dhe se këtë telefon e ka përdorur djali i tij deri në momentin kur është ftuar nga policia dhe e ka dorëzuar atë në polici. Pasi që kishte kuptuar se telefoni ishte vjedhur, kishte kërkuar sqarime nga i dënuari i cili ka mohuar se telefoni është i vjedhur dhe se policia i kishte treguar që janë duke e kërkuar të dënuarin dhe në qoftë se e sheh ta njoftojë. Po ashtu, nga shkresat e çështjes vërtetohet se i dënuari pasi që ishte kërkuar nga policia lidhur me telefonin i cili ishte gjetur te R.U., është mbrojtë se këtë telefon e ka blerë prej E.Xh. dhe atë disa ditë para se t’ia shet R.U.t. Mirëpo, gjykata e shkallës së parë ka administruar provën materiale – raportin e Policisë së Kosovës mbi kalimin kufitar, nga i cili raport është vërtetuar se personi me emër E.Xh., nuk ka hyrë në Kosovë nga data 12.2.2015, me çka ka vërtetuar se i njëjti fare nuk ka qenë në Kosovë ditën kur është kryer vepra penale, pra, rrjedhimisht edhe nuk ka mundur t’ia shet të njëjtin telefon të dënuarit.

Të gjitha këto janë prova të cilave i është referuar gjykata e shkallës së parë dhe me të cilat ka arsyetuar faktin se i dënuari K.A. ka kryer veprën penale e duke u mos u bazuar fare në identifikimin e të dënuarit si personi i cili ka kryer veprën penale. Në të njëjtin aktgjykim, gjykata e shkallës së parë, jep arsyetimin për të gjitha provat e administruara e veçanërisht për faktin se identifikimi është kryer në mënyrë jo konform dispozitave të KPPK-së, andaj nuk është bazuar fare në këtë provë, e çka e bën të paqëndrueshëm edhe pretendimin nga kërkesa.

Duke u bazuar në këtë gjendje faktike të vërtetuar të cilën e vërteton edhe gjykata e shkallës së dytë, drejt është aplikuar Ligji penal kur i dënuari është shpallur fajtor për veprën penale të grabitjes nga neni 329 par.1 të KPK-së.

Andaj, duke u nisur nga të gjitha këto si dhe nga fakti se ndaj të dënuarit nuk është shkelë ligji në dëm të tij, kjo Gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në kuptim të nenit 437 të KPPK-së.

GJYKATA SUPREME EKOSOVËS – PRISHTINË
PML.nr.308/2017, më datë 3.4.2018

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Nesrin Lushta